



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:047882

Datë: 23.01.2025

Numri i dokumentit: 06750638

KF.nr.825/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në konfliktin tregtar administrativ të paditësit “I - Dent - IC” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811255448, me seli në Fushë Kosovë, përfaqësuar nga Kushtrim Bytyqi, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Dogana e Kosovës, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulim vendimi, objekt i kontestit rivlerësim doganor, vlerë e kontestit 1,411.09€, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur me datë 14.01.2025 në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse avokat Kushtrim Bytyqi dhe në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur Xh. K., mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “I - Dent - IC” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811255448, me seli në Fushë Kosovë
- II. ANULOHET Aktvendimi me nr.01.3.2.2/24833 i datës 08.02.2022, i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. OBLIGOHET e paditura Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit “I - Dent - IC” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811255448, me seli në Fushë Kosovë, t’ia kthej shumën prej 1,411.09€ (një mijë e katërqind e njëmbëdhjetë euro e nëntë cent), të paguar më tepër, në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratës Unike Doganore me nr. R-18961/18.11.2021, të proceduar në Zyrën Doganore Aeroport, me kamatë ligjore prej 8% nga data e pagesës 19.11.2021 e deri në kthimin e plotë.
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

## A r s y e t i m

Paditësi “I - Dent - IC” Sh.P.K., me seli në Fushë Kosovë, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 11.03.2022, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, për anulimin e vendimit nr.01.3.2.2/24833 të datës 08.02.2022 të Doganës së Kosovës, për shkak të shkeljes së dispozitave të Kodit Doganor dhe të Akcizave, UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së parimeve dhe rregullave të procedurës administrative, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit, të anulohet vendimi i kontestuar i të paditurës, si dhe të detyrohet e paditura që të bëjë kthimin e mjeteve të paguara në emër të detyrimeve të importit në shumë prej 1,411.09€, me kamatë në shkallë prej 8% nga dita e pagesës 18.11.2021 e deri në kthimin e plotë. Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor publikë të datës 14.01.2025 përfaqësuesi i palës paditëse ka deklaruar se mbetet në tërësi si në të theksuarat në padi duke konsideruar se e paditura me anë të aktvendimit të atakuar ka bërë shkeljen e dispozitave ligjore të referuara në padi përkatësisht nenin 33 të KDAK lidhur me nenin 123 të UA nr.11/2009 pasi që paditësi DUD-it kontestues i ka bashkangjitur dokumentet relevante për të vërtetuar çmimin e transaksionit e të cilat janë sqaruar më në detaje në pikën 2.4 të padisë. E paditura ka refuzuar kërkesën e paditësit me arsyetimin se mungon kontrata e shitblerjes, por ky arsyetim konsideron se është i pa qëndrueshëm pasi që i njëjti dokument nuk përcaktohet obligativ me dispozitat ligjore të theksuara më sipër. E paditura përveç dokumenteve nuk ka marrë për bazë as praktikën doganore përmes të cilave paditësi edhe më parë kishte importuar mallin e njëjtë por i është pranuar çmimi i deklaruar. Duke marr për bazë të theksuarat edhe provat e administruara gjykatës i ka propozuar që të aprovojë kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të bazuar ashtu që të anulojë në tërësi aktvendimin e atakuar dhe të obligojë të paditurën që t’i kthej paditësit mjetet e paguara më tepër në emër të detyrimeve doganore sipas DUD kontestues për shkak të ri vlerësimit në shumë prej 1,411.09€ me kamatë në shkallë prej 8% nga data 19.11.2021 e deri në pagesën definitive

E paditura në përgjigje në padi të datës 27.11.2024 e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Më tej ka shtuar se vendimi i atakuar është marr konform dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marr me shkelje ligjore nuk qëndron, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marr konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të

drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme duke i propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoi si të pa bazuar dhe ta lë në fuqi vendimin kontestues si të ligjshëm. Gjatës seancës së shqyrtimit kryesor përfaqësuesi i palës së paditur ka deklaruar se pretendimet e paditësit të shprehura në padi nuk qëndrojnë se kinse e paditura ka bërë shkelje të KDAK-së e në lidhje me UA 11/2009. Këto pretendime janë të pabazuara sepse dispozitat e kodit doganore në kapitullin për vlerësimin e mallit në procedure doganore të paraqitur nga importuesi shprehet qartazi se kur Dogana e Kosovës si organ kompetent konstaton se paditësi ka deklaruar vlera më të ulëta në raport me të dhënat që i disponon dogana atëherë janë autorizimet ligjore për rivlerësimin e mallit e që në këtë rast është vlerësuar me MV6. Pretendimi tjetër i paditësit se e paditura ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotës të gjendjes faktike gjithashtu është pretendim i pabazuar sepse gjendja faktike është vërtetuar me rastin e shikimit të mallit dhe ku është përcaktuar se paditësi ka deklaruar vlera më të ulëta nga ajo që disponon e paditura. Ndërsa sa i përket precizimit të vlerës së kontestit e njëjta është e saktë. Më tej ka shtuar se gjithashtu pretendimet e paditësit nuk qëndrojnë kur thekson se e paditura në aktvendim ka konstatuar se paditësi nuk ka paraqitur kontratë, por siç shihet nga arsyetimi i aktvendimit e paditura e ka administruar kontratën të dorëzuar nga paditësi, por ka dhënë vërejtjet se ne kontratë nuk janë të cekura çmimet për njësi të mallit, e i cili paraqet element esencial për validitetin e kontratës. Nga administrimi i provave vërtetohet se paditësi me rastin e deklarimit të mallit ka deklaruar vlera më të ulëta në raport me të dhënat që i disponon Dogana e Kosovës dhe për gjykatës i ka propozuar që të refuzoj në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pabazuar dhe të lë në fuqi aktvendimin e Doganës së Kosovës.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor-publik të datës 14.01.2025 ka administruar provat si në vijim: Aktvendim nr. 01.3.2.2/24833 datë 01.08.2022, DUD R 18961 datë 18.11.2021, Faturë me nr. HC20211020GSJ001 me datë 20.10.2021, Pagesë ndërkombëtare e datës 08.11.2021, Faturë e transportit 2021-4988 dhe 2021-4909, Kontratë e distribuimit, Fotografii e printuar nga web faqja Alibaba.com, DUD-at referent bashkë me fatura, Proces mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, Dëshmi për pagesën e taksave doganore datë 19.11.2021.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, vlerësoi secilën provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, dhe duke u mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Në këtë procedurë gjyqësore të kontestit tregtar administrativ në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se subjekti “I-Dent-Ic” Sh.P.K, këtu paditësi, përmes Deklaratave unike doganore: R-18961 të proceduara në Zyrën Doganore Aeroport, ka deklaruar për zhdoganim mallin lëndor, sipas dokumentacionit përcjellës të mallit. Po ashtu, nuk ishte kontestuese as fakti tjetër që paditura e ka kontestuar vlerën e deklaruar të mallit nga paditësi, e ku si rezultat i kësaj përmes procesit mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, ka caktuar vlerë të re doganore për këtë mall, duke u bazuar në metodën e gjashtë. Jo kontestuese mbetet edhe fakti se paditësi ka ushtruar ankesë tek e paditura e për të cilën e paditura ka nxjerr vendimin 01.3.2.2/24833 të datës 08.02.2022 ndaj të cilit paditës me padi ka iniciuar këtë konflikt administrativ.

Kontestuese ndërmjet palëve mbetet harmonizimi i dokumentacionit, me qëllim të përcaktimit të vlerës reale të transaksionit sipas metodës së parë të vlerësimit të parashikuar në KDAK.

Nga arsyetimi i vendimit kontestues gjykata konstaton se e paditura ka refuzuar ankesën e paditësit për arsye se Sektori i Pranimit Qendror ka vepruar drejtë kur ka kontestuar vlerën e mallit lëndor pasi që vlerat e mallit të deklaruar për zhdoganim nuk është vlerë reale e paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë për arsye se është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar apo që ka për t'u paguar për mallin e shitur për eksport përkatësisht për import në vendin tonë në vështrim të nenit 33, të Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës. Po ashtu Sektori i Pranimit Qendror ka vepruar drejtë kur gjatë vlerësimit të mallit është bazuar në metodën e gjashtë të vlerësimit, neni 35, të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, respektivisht në bazë të dhënave të disponueshme, të Doganës së Kosovës. Dokumentet përcjellëse të mallit lëndor janë vlerësuar si prova të pamjaftueshme pasi që kontrata e distribuimit e prezantuar nga subjekti ankimor nuk ka cekur çmimin për njësi të mallit, i cili është element esencial i një kontrate lidhur

me kontrktimin e mallit, madje Dogana e Kosovës disponon me të dhëna tjera dhe se subjekti në procedurë nuk ka deklaruar vlerën reale të mallit lëndor kontestues, andaj në bazë të karakteristikave të ngjashme të mallit është përcaktuar edhe çmimi për mallin lëndor kontestues, në këtë kuptim dogana e Kosovës ka bërë vlerësimin e prova që ka prezantuar subjekti ankimor me provat që kanë shërbyer për referencë të vlerësimit të mallit, gjithnjë duke pasur parasysh që Dogana e Kosovës disponon me të dhëna të disponueshme lidhur me vlerën e mallit, andaj vlera e deklaruar nga Dogana e Kosovës konsiderohet si vlera reale e mallit.

Me Dispozitën ligjore të nenit 33 par 1 të KDAK-së është përcaktuar se *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshatur, sipas nevojës, në përputhje me nenet 36 dhe 37”*.

Tutje, në paragrafin 3 të nenit 33 të KDAK-së përcaktohet se *“Çmimi vërtetë i paguar apo i pagueshëm është pagesa e plotë e bërë ose që duhet bërë nga blerësi për shitësin ose në dobi të këtij të fundit për mallin e importuar dhe që përfshin të gjitha pagesat e bëra ose që duhen bërë, si kusht i shitjes së mallrave të importuara nga blerësi për shitësit, ose nga blerësi për një palë të tretë për ta përmbushë obligimin ndaj shitësit. Pagesa mund të mos bëhet patjetër në formën e transferit të parave. Pagesa mund të bëhet me anë të letrave të kredisë ose ndonjë mjeti tjetër të dakorduar të pagesës dhe mund të bëhet drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë”*. Ndërsa, se cilat dokumente duhet t’i bashkëngjiten deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë të mallit, është e rregulluar me nenin 123 par. 1 pika (a) të UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr.03/L-109, ku decidivisht përcaktohet se *“a) fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti”*.

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykatës i rezultoi një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ. Gjykata konstaton se dokumentacioni për mallin lëndor i paraqitur në procedurën administrative dhe në këtë konflikt administrativ është i mjaftueshëm për të konstatuar se vërtet paditësi ka paguar vlerën reale të mallit lëndor.

Deri te ky konstatim gjykata erdhi pas analizimit të faturës nr.HC20211020GSJ001 të datës 20.10.2021 më vlerë prej 7,723.00USD, urdhërpagesës bankare ndërkombëtare të datës 08.11.2021 ne vlerë prej 7,723.00USD me përshkrimin “pagesë e faturës nr. HC20211020GSJ001”, të cilat janë në përputhje të plotë me vlerën e DUD-it kontestues R-18961/18.11.2021.

Po ashtu Gjykata konstaton se aplikimi i metodës së 6 të vlerësimit në vështrim te nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave, është veprim i cili bie ndesh me dispozitat e nenit 33-35 të Kodit Doganor dhe te Akcizave nr.03/L109, për arsye, se para se të aplikohet metoda e fundit e vlerësimit gjegjësisht metoda e 6 e vlerësimit, duhet te jepen arsyet dhe provat për ta kontestuar vlerën e mallit lëndor.

Nga kjo gjendje faktike, Gjykata vlerëson se e paditura pa bazë ligjore dhe prova materiale të besueshme e ka rivlerësuar mallin lëndor të deklaruar për zhdoganim nga paditësi, përmes DUD-it, R-18961/18.11.2021, të proceduar në Zyrën Doganore Aeroport, dhe në këtë mënyrë të njëjtin e ka obliguar pa të drejtë me pagesën e detyrimeve shtesë importuese doganore në shumë prej 1,411.09€, mbi vlerën e deklaruar të mallit të importuar.

Gjykata nga shkresat e lëndës vlerëson se me asnjë provë nuk është provuar konstatimi i të paditurës i dhënë në vendimin e kontestuar, sipas të cilit vlera e deklaruar e mallit lëndor nga paditësi, nuk është vlera reale e paguar e mallit me qëllim importi në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDAK-së.

Arsyetimi i të paditurës i dhënë në vendimi e kontestuar se në kontratën e shitblerjes nuk janë cekur çmimet për njësi të mallit, prandaj kontrata e shitblerjes nuk mund të pranohet, për gjykatën nuk është i bazuar, sepse me dispozitat e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr.03/L-109 dhe as me dispozitat e UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave, nuk parashihet që kontrata e shitblerjes është dokument i cili duhet bashkangjitur deklaratës doganore, për vendosje në qarkullim të lirë të mallit të importuar dhe për tu aplikuar metoda e parë e vlerësimit sipas nenit 33 par.1 të KDAK-së.

Gjykata konstaton se në rastin konkret paditësi ka vërtetuar se pagesa e faturës nr.HC20211020GSJ001 të datës 20.0.2021 e deklaruar me DUD-in R-18961/18.11.2021 është realizuar përmes transferit ndërkombëtar me numër të urdhërpagesës ref:563823057 me datë 08.11.2021 në vlerë prej 7,723.00 USD, në të cilën pagesë është shënuar numri i faturës.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se të gjitha dokumente e prezantuar të paditurës lidhur me deklaratën unike doganore kontestuese, rezultojnë të jenë të harmonizuara në tërësi sa i përket vlerës së mallit të importuar nga paditësi konform nenit 33 par.1 të KDAK-së.

Prandaj nga gjendja faktike e vërtetuar më lartë, Gjykata pretendimet e paditësit lidhur me deklaratën unike doganore kontestuese, i vlerësoi si tërësisht të bazuar dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore për zhdoganimin e mallit lëndor, konform nenit 33 par.1 të Kodit Doganor dhe të Akcizave.

Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 46 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ashtu që aprovoi kërkesëpadinë e paditësit, e anuloi vendimin e kontestuar të të paditurës dhe e detyroj të paditurën që paditësit t'i kthej shumën prej 1,411.09€ të paguar më tepër për shkak të rivlerësimit jo të drejtë të mallit, në emër të detyrimeve importuese, për mallin e zhdoganuar përmes DUD-it kontestues të proceduar në ZD Aeroport, me kamatë ligjore prej 8 % nga data e pagesës 18.11.2021 e deri në kthimin e plotë.

Sa i përket kamatës gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, sipas kërkesës së paditësit, duke pasur parasysh dispozitën e nenit 292 pika b) (i), të KDAK-së nr.03/L-109, ku parashihet *“Në rast se çështja zgjidhet përfundimisht në instance të fundit sipas mjetit të ushtruar në favor: Të Apeluesit, Dogana duhet që: (i) të rikthejë çdo detyrim të importit apo eksportit të paguar më tepër bashkë me kamatën e grumbulluar deri në momentin e zgjidhjes së kontestit nëse është e aplikueshme”* dhe dispozitat ligjore të nenit 170 të Ligjit nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku thuhet se *“Detyrimi i shpërblimit të dëmit konsiderohet se ka arritur, për pagesë që nga momenti i shkaktimit të dëmit”* dhe nenit 382 paragrafi 2 të këtij ligji ku thuhet se *“Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të*

veçantë”, ndërsa lidhur me datën e rrjedhës së kamatës sipas kërkesës së palës paditëse ka marrë datën data 18.11.2021 si datë e pagesës.

Gjykata i ka vlerësuar deklaratimet dhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative.

Vendimin që secila palë t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga të lartcekurat, gjykata konform nenit 46 par. 2, 4 dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal  
KF.nr.825/22, datë 14.01.2025

Gjyqtarja  
Vera Gashi Bala

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.